



V E N D I M

K.P.P.149/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.03.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sulollari” sh.p.k nga procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-42444-01-27-2018 me objekt “Blerje lende djegëse për ngrohje – Pellet” me fond limit 2,940,000 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 08.02.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë.

Ankimues:

“Sulollari” shpk
Rruga “Muhamet Gjollesha” 71/3 Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë
Rruga “ Onhezmi “ lagja Nr 3

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili nuk e ka pranuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.01.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-42444-01-27-2018 me objekt “Blerje lende djegese per ngrohje – Pellet” me fond limit 2,940,000 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 08.02.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë.

II.2 . Në datën 08.02.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 12.02.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Sulollari 2,820,000 I skualifikuar
- Aivini 2,940,000 I kualifikuar

II.4. Në datën 12.02.2018 operatori ekonomik “Sulollari” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

1. Operatori ekonomik Sulollari shpk nuk ploteson piken 2.3 Kapaciteti teknik , pika 2 ku percaktohet : Te kete gjendje 1 (nje) copë kaldaja per pellet (me fuqi 220-260 KË) me keto te dhena: Me dokumentacionit te paraqitur, deklarata doganore R 66005 date 02.11.2013 nuk ploteson kerkesat teknike te percaktuara nga AK në piken 2 te Kapaciteti Teknik . Me dokumentacionit te paraqitur, deklarata doganore R 69575 date 10.09.2015 nuk ploteson kerkesat teknike te percaktuara nga AK në piken 2 te Kapaciteti Teknik .

2. Operatori ekonomik Sulollari shpk nuk ploteson piken 2.3 Kapaciteti teknik , pika 4 ku percaktohet : Te kete gjendje 1 (nje) bruciator per pellet me keto karakteristika teknike: Me dokumentacionit te paraqitur, deklarata doganore R 69575 date 30.09.2015 nuk ploteson kerkesat teknike te percaktuara nga AK ne piken 4 te Kapaciteti Teknik

3. Operatori ekonomik Sulollari shpk nuk ploteson piken 2.3 Kapaciteti teknik , pika 5 ku percaktohet : Te kete gjendje 1 (nje) bruciator per pellet me keto karakteristika teknike: Me dokumentacionit te paraqitur, deklarata doganore R 69575 date 30.09.2015 nuk ploteson kerkesat teknike te percaktuara nga AK ne piken 5 te Kapaciteti Teknik

II.5. Në datën 14.02.2018, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

1. Ju në kërkesat për kualifikim kërkon: Te kete gjendje 1 (nje) copë kaldaja per pellet (me fuqi 220-260 KW) me keto te dhena:

- Tipi KN-AT
- Fuqia min/max e punes 220 - 260 kw
- Fuqia termike nominale 230 kw
- Fuqia termike e kthyer 250 kw
- tensioni i punes (elektrik) 380 v
- Fuqia motorrike 1100 W
- Rendimenti 87 %
- Presioni i ujit 1,5 - 3,8 bar
- Lartesia 2750 mm
- Gjatesia 2180 mm

- Gjeresia 1720 mm
- Pesha 1400 kg
- Kapaciteti i ditor i silozit 1,1 m³

3. Te kete gjendje 2 (dy) copë kaldaja per pellet (me fuqi 480 – 500 KW) me keto te dhena:

- Tipi KN-AT
- Fuqia min/max e punes 392 - 530 kw
- Fuqia termike nominale 500 kw
- Fuqia termike e kthyer 459 kw
- tensioni i punes (elektrik) 380 v
- Fuqia motorrike 1100 W
- Rendimenti 87 %
- Presioni i ujit 1,5 - 3,8 bar
- Lartesia 2750 mm
- Gjatesia 2180 mm
- Gjeresia 1720 mm
- Pesha 1855 kg
- Kapaciteti i ditor i silozit 1,5 m³



4. Te kete gjendje 1 (nje) bruciator per pellet me keto karakteristika teknike:

- modeli BP 250 kw
- fuqia min/max ne kë 190-250 kw
- tensioni i punes (elektrik) 220 V
- fuqia e motorit te ventilatorit 190 W
- Kandelet e ndezjes 2 cope 750 W
- Rendimenti 85 %
- dimensionet 360 x 420 x 1200 mm
- shneku me diameter 110 mm
- fuqia e motorit te shnekut 180 W
- dimensionet tubit te shkarkimit 75 mm

5. Te kete gjendje 2 (dy) bruciator per pellet me keto karakteristika teknike :

- modeli BP 500 kw
- fuqia min/max ne kë 400 – 500 kw

- *tensioni I punes* 220 v
- *fuqia e punes se ventilatorit* 190 w
- *Kandelet e ndezjes 2 cope* 750 w
- *Rendimenti* 85 %
- *dimensionet* 380 x 420 x 1250 mm
- *shneku me diameter* 125 mm
- *fuqia e motorit te shnekut* 190 w
- *dimensioni i tubit te shkarkimit* 75 mm

Operatori ekonomik qe kualifikohet duhet ti kete te montuara paisjet djegese te pelletit nga data e fillimit te kontrates deri ne perfundimin e saj , prane Autoritetit kontraktor.

- *Paisjet teknike (kaldajat dhe djegësit/bruciatorët) duhet të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ose me kontrate qeraje te noterizuar.*

Për të vërtetuar këtë , operatori ekonomik duhet të paraqesë akt çdoganimi , kontratë shitblerje te noterizuar.

Për paisjet teknike të marra me qera duhet të paraqitet kontratë qeraje noteriale e shoqëruar me dokumentin e pronësisë së qiradhënësit (akt çdoganimi ose kontratë shitblerje).

- *Duke parë dokumentat të cilat ne i kemi ngarkuar në sistem vërtetohet mjaft qartë pronësia e të gjitha pajisjeve të cilat ju kërkoni. Këto pajisje vërtetohen që janë në pronësinë tonë nëpërmjet faturave të blerjes dhe deklaratave doganore. Ju të nderuar anëtarë të KVO-së nuk e keni shprehur ose kërkuar që këto akte zhdoganimi apo pajisje në pronësi të jenë të shoqëruara dhe me specifikimet teknike sepse në të gjitha faturat e blerjeve nuk shprehen specifikimet teknike. Ju këto specifikime mund ti shihni kur pajisja që ju kërkoni të vijë në institucionin tuaj dhe më pas vetë pajisja është e shoqëruar me katalog, me të dhënat teknike apo me certifikata etj. Ju kërkoni që pajisja të ketë specifikimet që ju doni, atherë ju lutem më shpjegoni ku i vërtetuat ju nëpërmjet faturës së blerjes apo deklaratës doganore që pajisja nuk plotëson kriteret tuaja. Ju mund të kishit kërkuar në DST katalogjet përkatëse për të parë specifikimet. Gjithashtu mund të shikoni nëpërmjet historikut të QKR dhe objektet e firmave pjesmarrëse në tender për tu njohur kështu dhe me fushën e veprimtarisë së firmës pjesmarrëse dhe me eksperiencat e punës në këto fushë.*

II.6. Në datën 16.02.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.228 prot i kthen përgjigje palës ankimuese duke vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik.

II.7. Në datën 19.02.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.270 prot., datë 26.02.2018 protokolluar me tonën me nr.287/2 datë 28.02.2018 me objekt “Dërgohet informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Sulollari” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Operatori ekonomik Sulollari shpk nuk ploteson piken 2.3 Kapaciteti teknik , pika 2 ku percaktohet : Te kete gjendje 1 (nje) copë kaldaja per pellet (me fuqi 220-260 KË) me keto te dhena: Me dokumentacionit te paraqitur, deklarata doganore R 66005 date 02.11.2013 nuk ploteson kerkesat teknike te percaktuara nga AK në piken 2 te Kapaciteti Teknik . Me dokumentacionit te paraqitur, deklarata doganore R 69575 date 10.09.2015 nuk ploteson kerkesat teknike te percaktuara nga AK në piken 2 te Kapaciteti Teknik .

2. Operatori ekonomik Sulollari shpk nuk ploteson piken 2.3 Kapaciteti teknik , pika 4 ku percaktohet : Te kete gjendje 1 (nje) bruciator per pellet me keto karakteristika teknike: Me dokumentacionit te paraqitur, deklarata doganore R 69575 date 30.09.2015 nuk ploteson kerkesat teknike te percaktuara nga AK ne piken 4 te Kapaciteti Teknik

3. Operatori ekonomik Sulollari shpk nuk ploteson piken 2.3 Kapaciteti teknik , pika 5 ku percaktohet : Te kete gjendje 1 (nje) bruciator per pellet me keto karakteristika teknike: Me dokumentacionit te paraqitur, deklarata doganore R 69575 date 30.09.2015 nuk ploteson kerkesat teknike te percaktuara nga AK ne piken 5 te Kapaciteti Teknik, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,


III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Informacione dhe formalitete të nevojshme për të vlerësuar nëse janë përmbushur kërkesat:

2. Te kete gjendje 1 (nje) copë kaldaja per pellet (me fuqi 220-260 KW) me keto te dhena:

• Tipi	KN-AT
• Fuqia min/max e punes	220 - 260 kw
• Fuqia termike nominale	230 kw
• Fuqia termike e kthyer	250 kw
• tensioni i punes (elektrik)	380 v
• Fuqia motorrike	1100 W
• Rendimenti	87 %
• Presioni i ujit	1,5 - 3,8 bar
• Lartesia	2750 mm
• Gjatesia	2180 mm
• Gjeresia	1720 mm
• Pesha	1400 kg
• Kapaciteti i ditor i silozit	1,1 m ³

3. Te kete gjendje 2 (dy) copë kaldaja per pellet (me fuqi 480 – 500 KË) me keto te dhena:



• Tipi	KN-AT
• Fuqia min/max e punes	392 - 530 kw
• Fuqia termike nominale	500 kw
• Fuqia termike e kthyer	459 kw
• tensioni i punes (elektrik)	380 v
• Fuqia motorrike	1100 W
• Rendimenti	87 %
• Presioni i ujit	1,5 - 3,8 bar
• Lartesia	2750 mm
• Gjatesia	2180 mm
• Gjeresia	1720 mm
• Pesha	1855 kg
• Kapaciteti i ditor i silozit	1,5 m ³


4. Te kete gjendje 1 (nje) bruciator per pellet me keto karakteristika teknike:

• modeli	BP 250 kw
• fuqia min/max ne kë	190-250 kw

- *tensioni i punes (elektrik)* 220 V
- *fuqia e motorit te ventilatorit* 190 W
- *Kandelet e ndezjes 2 cope* 750 W
- *Rendimenti* 85 %
- *dimensionet* 360 x 420 x 1200 mm
- *shneku me diameter* 110 mm
- *fuqia e motorit te shnekut* 180 W
- *dimensioni tubit te shkarkimit* 75 mm

5. *Te kete gjendje 2 (dy) bruciator per pellet me keto karakteristika teknike :*

- *modeli* BP 500 kw
- *fuqia min/max ne kë* 400 – 500 kw
- *tensioni I punes* 220 v
- *fuqia e punes se ventilatorit* 190 w
- *Kandelet e ndezjes 2 cope* 750 w
- *Rendimenti* Alb 85 %
- *dimensionet* 380 x 420 x 1250 mm
- *shneku me diameter* 125 mm
- *fuqia e motorit te shnekut* 190 w
- *dimensioni i tubit te shkarkimit* 75 mm



Public Health Sector

- *Operatori ekonomik qe kualifikohet duhet ti kete te montuara paisjet djegese te pelletit nga data e fillimit te kontrates deri ne perfundimin e saj , prane Autoritetit kontraktor.*
- *Paisjet teknike (kaldajat dhe djegësit/bruciatorët) duhet të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ose me kontrate qeraje te noterizuar.*
- *Për të vërtetuar këtë , operatori ekonomik duhet të paraqesë akt çdoganimi , kontratë shitblerje te noterizuar.*
- *Për paisjet teknike të marra me qera duhet të paraqitet kontratë qeraje noteriale e shoqëruar me dokumentin e pronësisë së qiradhënësit (akt çdoganimi ose kontratë shitblerje).*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “Sulollari” shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë gjendje me anë të së cilës deklarohet se operatori ekonomik Sulollari shpk ka gjendje kaldajat dhe brucatorët për pelet në sasinë dhe karakteristikat e kërkuara në DST.
- Faturë Tatimore Shitje Nr.271 datë 15.01.2017 me përshkrim: kaldaja 500 kw copë 2.
- Deklaratë Doganore R 66005 datë 02.11.2013 me përshkrim Kaldajë për ngrohje qëndrore 1 copë (e përbërë nga kazani dhe kapakët)
- Deklaratë Doganore R 69575 datë 30.09.2015 me përshkrim Kaldajë ngrohje shtëpie....
- Deklaratë Doganore R69575 datë 30.09.2015 me përshkrim Djegës naftë , sprucator për sistem ngrohje 1 copë.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Në nenin 53, pika 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, theksohet që: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.4. Referuar kriterit të vecantë të kualifikimit, KPP vëren se autoriteti kontraktor ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetojnë me dokumentacion provues disponimin e 3 kaldajave përkatësisht një kaldajë për pellet (me fuqi 220-260 KW) dhe 2 kaldaja për pellet me fuqi (480 – 500 KW). Gjithashtu autoriteti kontraktor ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetojnë me dokumentacion provues disponimin e tre bruciatorëve me karakteristika teknike të ndryshme. Në rastin kur pajisjet teknike janë në pronësi autoriteti kontraktor ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të paraqesin akt zhdoganimi, kontratë shitblerje noteriale dhe në rastin kur disponohen me anë të kontraës së qerasë, kontrate qeraje noteriale shoqeruar me dokumentin e pronesisë ose qiradhenesit (kontrat shitblerje ose akt zhdoganimi).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ankimesi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se është dorëzuar një deklaratë e thjeshtë me anë të së cilës deklarohet se operatori ekonomik Sulollari shpk ka gjendje kaldajat dhe brucatorët për pelet në sasinë dhe karakteristikat e kërkuara në DST, një faturë tatimore me anë të së cilës provohet se operatori ekonomik ka blerë dy kaldaja me kapacitet 500KW si dhe akte zhdoganimi të cilat janë sërish me përshkrim kaldajë për ngrohje, dhe djegës naftë, sprucator.

KPP vëren se operatori ekonomik “Sulollari” shpk nuk e ka shoqëruar deklaratën e tij me ndonjë dokument të vlefshëm ligjor, i cili të vërtetojë ekzistencën e të gjitha mjeteve të kërkuara në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi nga autoriteti kontraktor, konkretisht të tre bruciatorëve të kërkuar në kriterin e kualifikimit.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se me paraqitjen e dokumentacionit të lartpërmendur, operatori ekonomik Sulollari shpk nuk ka arritur të vërtetojë se gëzon të drejtën e pronësisë (gëzon, posedon dhe disponon lirisht sendin brenda kufijve të përcaktuar me ligj), apo të drejtën e përdorimit në cilëndo formë të njohur nga legjislacioni shqiptar (qira, huapërdorje, etj), mbi tre bruciatorë të kërkuar në kriterin e kualifikimit.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër, pretendimet e ankimesit nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sulollari” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-42444-01-27-2018 me objekt “Blerje lende djegese per ngrohje – Pellet” me fond limit 2,940,000 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 08.02.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 287 Protokoli, Datë 19.02.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Kryetar
Evis Shurdha

